



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:109396

Datë: 19.03.2024

Numri i dokumentit: 05474193

KF.nr.83/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit “Bashkimi” Sh.P.K., me numër të regjistrimit të biznesit 7032886 dhe seli në fshatin Gllobar Komuna e Gllogovc, të cilin e përfaqëson M.B., aksionar në kompani, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit të ATK-së nr.164/2020 të datës 04.08.2020, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor- publik, të mbajtur në prani të përfaqësuesit të palës paditëse M.B., e në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur, me datë 11.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit “Bashkimi” Sh.P.K., me seli në fshatin Gllobar, Komuna e Gllogovcit, si e bazuar.
- II. ANULOHET vendimi nr.164/2020 i datës 04.08.2020 i Administratës Tatimore të Kosovës.
- III. Obligohet e paditura Administrata Tatimore që paditësin “Bashkimi” Sh.P.K., ta liroj në tërësi nga ngarkesa dhe pagesa për të gjitha llojet e tatimit shtesë në total prej 310,291.80 € (treqind e dhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e një euro e tetëdhjetë cent).
- IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A R S Y E T I M

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë me datë 07.09.2020, ka iniciuar kontestin tregtar-administrativ kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, me të cilën ka

kërkuar anulimin e vendimit nr.07/2017 të datës 22.02.2017, përkatësisht anulimin e vendimit nr.164/2020 i datës 04.08.2020. Përfaqësuesi i palës paditëse në seancë ka deklaruar se në periudhën e ngarkimit mbi deponimet bankare nuk ka asnjë dispozitë ligjore apo udhëzime administrative të cilat parashohin shprehimisht se deponimet bankare janë si kategori e të ardhurave bruto, edhe për kundër provave dhe argumenteve të prezantuara nga ana e paditësit e paditura nuk ka argumentuar cila është dispozita apo baza ligjore kur deponimet i trajton si të hyra të tatueshme në të cilën në asnjë provë dhe nga shkresat e lëndës nuk dëshmon se paratë e deponuara në llogarinë bankare janë nga aktiviteti ekonomik. Tutje ka theksuar se e paditura nuk ka marrë në konsideratë se deponime bankare nuk kanë rrjedhur nga qarkullimi i aktivitetit ekonomik të biznesit me qëllim që të i ikë obligimit tatimor, ku një pjesë e deponimeve bankare janë tërhequr nga banka Private e Biznesit dhe po në të njëjtën ditë janë deponuar në Raiffeisen Bankë apo brenda një periudhe të shkurtë kohore, arsyeja e tërheqjeve nga BPB dhe deponimi në Raiffeisen Bankë ishte se operatori ekonomik Bashkimi Sh.P.K ishte në vonesë e shlyerjes së kredisë në Raiffeisen Bankë. Shton se Bashkimi Sh.P.K dhe Raiffeisen Bankë ishin dakorduar që për të mos ngarkuar me ndëshkime shtesë mjetet ti depononin kesh në Raiffeisen Bankë, çdo herë para deponimit duhej të njoftohej Raiffeisen Bankë për ti ikur penalizimit, ndërsa sa i përket kontratave të huazimit me persona fizik këtu janë mjete të marrura hua për arsye se operatori ekonomik Bashkimi Sh.P.K kishte marrë punime në institucione të ndryshme të Kosovës dhe nuk kishte mjete të mjaftueshme për realizmin e këtyre punimeve. Më tej ka shtuar se Referuar Raportit inspektues të kontrollit e paditura nuk e ka sqaruar se cili ka qenë fakt ose provë vendimtare në të cilën edhe DA i ka pasur në dispozicion për të konstatuar se keshi i deponuar në llogarinë bankare është nga burimi i tatueshëm dhe nuk ka arsyetuar se si ka vendosur se si ky kesh të trajtohet si e hyrë shtesë në biznesin jashtë të hyrave të deklaruara. Po ashtu ka theksuar se e paditura në ngarkimin e deponimeve bankare ka bërë shkelje të dispozitave ligjore duke mos trajtuar në mënyrë të barabartë me operatorët ekonomik në rrethana dhe fakte të njëjta juridike. Gjykatës i ka propozuar që të aprovoj kërkesëpadinë si të bazuar, të anuloj vendimin kontestues dhe të obligoj të paditurën që paditësin ta liroj nga qarkullimi shtesë.

E paditura në përgjigje në padi të datës 13.07.2021 ka deklaruar se vendimi i kontestuar është i drejtë dhe në harmoni me legjislacionin tatimor të aplikueshëm në Republikën e Kosovës si dhe i bazuar në vërejtjet të cilat DA i ka marrë në Aktgjykimin A.nr.519/17. Ka theksuar se metoda e Depozitave Bankare dhe Shpenzimet e Keshi-it është bazuar në teorinë që një tatimpagues merr dhe mund të ndodhin dy gjëra: ato ose mund të depozitohen ose mund të shpenzohen. Ka shtuar se përcaktimi se sa mjete të depozituara janë shpërndarë apo akumuluar

(kujt dhe për çfarë qëllimi) mund gjithashtu të jap drejtime në burime tjera të të ardhurave. Tutje shton se si palë e paditur nuk ka trajtuar (ngarkuar) si të hyra deponimet nga pazaret ditore të paditësi dhe deponimet nga huazimet dhe deponimet nga qarkullimi ditor nuk janë trajtuar si të hyra dhe kjo nuk ka mundur të bëj dyfishimin e trajtimit të të hyrave. Më tutje ka theksuar se ATK ka bërë trajtimin e të hyrave nga deponimet e paargumentuara me prova materiale duke u trajtuar me qarkullim dhe tatim shtesë në TVSH dhe TAK për periudhën e kontrollit dhe këto vlera janë specifikuar për çdo deklaratë tatimor në raportin e kontrollit. Po ashtu ka shtuar se pretendimet e paditësit lidhur me trajtimin e tërheqje/deponimeve brenda ditës i cili ka pretenduar se i janë trajtuar si të hyra nuk qëndron për faktin se pas analizimit të të gjitha këtyre deponimeve është konstatuar se të njëjtit nuk korrespondojnë me datat e tërheqjeve, vlerat e mjeteve nga një llogari dhe deponimet në të njëjtën datë dhe në të njëjtën vlerë dhe kjo çështje është marr parasysh edhe gjatë fazës së kontrollit tatimor e cila vërehet në fletat e punës se këto deponimet (brenda ditës tërheqje/deponim) nuk janë trajtuar si të hyra por vetëm deponimet e paargumentuar nga paditësi. Gjykatës i ka propozuar që pas administrimit të provave dhe analizimit të dispozitave ligjore relevante, ta refuzoj në tërësi si të pabazuar padinë e paditësit dhe ta vërtetoj si të drejtë dhe të bazuar në ligj Vendimin e DA të ATK-së me nr.164/2020 i datës 04.08.2020.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor - publik të datës 11.03.2024, ka administruar provat dhe atë: Vendimi i ATK-së me nr. 164/2020 i datës 04.08.2020, Aktgjykimi A.nr.519/17, Vendimi nr.07/2017 i datës 22.02.2017, Kontratat e huas të paditësit të nënshkruara me persona fizik, Vendimi i ATK-së me nr. protokolli 610/2016 PR2 i datës 14.12.2016 për vlerësim të ndëshkimeve dhe gjobave, Raporti i kontrollit i ATK-së i datës 12.12.2016, Raporti i kontrollit i ATK-së i datës 14.11.2019 për subjektin NSM Trade Sh.P.K, Raporti i kontrollit i ATK-së për subjektin "NSM Trade " i datës 26.11.2019, Pasqyrat e llogarisë bankare te paditësit ne bankat NLB – Prishtina, Raiffeisen Bankë, BPB, Gjendja e borxheve e paditësit ne ATK e datës 30.09.2019, Përgjigje në padi e datës 13.07.2021, Ankesa e tatim paguesit në DA e datës 12.01.2017.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe

arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar administrativ, deklarimeve në padi dhe përgjigje padi, shkresat e lëndës, vendimi kontestues, dhe deklarimit në seancën e shqyrtimit gjyqësor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese fakti se ATK-Zyra Regjionale Prishtina 2, me datë 12.12.2016 ka kryer kontroll tatimor për subjektin “Bashkimi” Sh.P.K., me seli në fshatin Gllobar-Drenas, këtu paditësin për periudhat dhe llojet e tatimeve: Tatim mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), Tatim të Mbajtur në Burim (WM) dhe kontribute Pensionale (CM), për periudhat 02/2010-02/2016, si dhe për Tatim në të Ardhurat të Korporatave (CD) për periudhën 2020-2015, me kontroll paditësi është ngarkuar me tatim shtesë për TVSH në TAK në shumë prej 33,182.33€, pa përfshirë ndëshkimet dhe interesin e kalkuluar sipas ligjit. Jo kontestuese mbesin edhe faktet se paditësi ka ushtruar ankesë, pran departamentit të ankesave në ATK, për të cilën ankesë ATK-ja ka nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë vendimin nr.07/2017 të datës 22.02.2017, kundër të cilit vendimi paditësi ka bërë padi me datë 21.03.2017. Nuk është kontestuese as fakti se Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative Divizioni Fiskal me numër A.nr.519/17 ka sjell Aktgjykim me të cilën e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, dhe ka anuluar vendimin nr.07/2017 i datës 22.02.2017 i Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje. Tutje Administrata Tatimore e Kosovës duke vepruar sipas Aktgjykimit A.nr.519/17 ka sjell vendimin nr.164/2020 të datës 04.08.2020 me të cilën e ka refuzuar si të pabazë ankesën nr.164/2020 të datës 04.06.2019. Kundër këtij vendimi paditësit me datës 07.09.2020 ka paraqitur padi pran Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative Divizioni Fiskal.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues nr.164/2020 të datës 08.04.2020 Gjykata konstaton se e paditura Administrata Tatimore e Kosovës, nuk ka qenë në gjendje për asnjë moment të arsyetoj se mbi cilën bazë ligjore ka ngarkuar këtu paditësin me qarkullim shtesën në total prej 310,291.80 respektivisht sipas viteve 115,630.18 € për vitin 2010, shumë prej 80,656.40 € për vitin 2011, shuma prej 101,531.55 € për vitin 2012 dhe shuma prej 2,473.67 € për vitin 2013. Po ashtu gjykata vëren se në vendim kontestues e paditura nuk i ka marr për bazë vërejtje e gjykatës sipas Aktgjykimit A.nr.519/17 për treguar saktë se cilat nga metodat indirekte e ka përdoruar e aq më pak nuk e ka sqaruar faktin dhe arsyen eventuale të aplikimit të këtyre metodave, por vetëm e ka shpjeguar faktin se në çka bazohet njëra prej metodave,

dhe vetëm është thirrur në dispozitën e nenit 19 paragrafi 2 i Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore të Kosovës.

Nga kjo gjendje faktike gjykata konstaton se e paditura me anë të vendimit kontestues nuk ka mundur të shpjegoj qartazi se çka nënkupton me të ardhura bruto, dhe çka do të përfshiheshin si objekt i tatimit. Gjkata i vlerësoj të drejtë pretendimet e paditësit që në periudhën e ngarkimit mbi deponimet bankare nuk ka asnjë dispozitë ligjore apo udhëzim administrativ të cilin parashohin shprehimisht se deponimet bankare janë si kategori e të ardhurave bruto.

Nga vendimi i kontestuar dhe raporti i kontrollit, gjykata po ashtu konstaton se e paditura ka bërë shkelje të dispozitave ligjore, duke mos e trajtuar në mënyrë të barabartë me operatorët ekonomik në rrethanat dhe faktet juridike, lidhur me këtë fakt ka dhënë vetëm arsyetimin se është përgjegjësi individuale e Drejtorisë Rajonale Prishtina II.

Nga kjo gjendje e fakteve, gjykata i vlerësoj të drejta pretendimet e paditësit sa i përket qarkullimit dhe tatimit shtesë i cili ka rezultuar me Raportin e Kontrollit të ATK-së, ngase e paditura me asnjë provë apo dispozitë ligjore nuk e ka argumentuar se deponimet bankare janë si kategori e të ardhura bruto.

Gjkata ka vlerësuar edhe theksimet dhe provat e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitë nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Mbi bazën e të lartshënuarve, gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 81.I par.2 pika 2.1 të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, dhe nenit 46 par.2 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.83/22, datë 11.03.2024

Gjyqtarja

Vera Gashi Bala

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.